



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
QENDRA KOMBËTARE E CILËSISË, SIGURISË DHE AKREDITIMIT TE
INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE (QK-CSA)**

Bulevardi Zogu I, Spitali Universitar Obs. – Gjin. “Mbreteresha Geraldine” Tirane ALBANIA

Tel:+355-4-23 42 21/Fax: +355-4-23 42 25

Web: www.qkcsaish.gov.al

Email:info@qkcsaish.gov.al

NJOFTIM

Ftesë për Tavolinë të rrumbullakët; “Menaxhimi i rreziqeve dhe i Sigurisë në spitale”

Menaxhimi i rreziqeve dhe i Sigurisë në spitale si për të sëmurët ashtu dhe për personelin, është bërë një çështje e mprehtë e cila kërkon reagim dhe zgjidhje urgjente. Për këtë arsye Qendra Kombëtare e Cilësisë dhe Sigurisë e cila e ka këtë problem në mandatin dhe prioritet e saj ju fton të merrni pjesë në një “Tavolinë të rrumbullakët diskutimi” me të gjitha palët e interesuara; përfaqësues të sëmurëve, profesionistë mjekë dhe infermierë, pedagogë e drejtues të departamenteve dhe shërbimeve universitare, përfaqësues të spitaleve të rretheve, drejtues të institucioneve dhe të Ministrisë së Shëndetësisë, përfaqësues të Medias. Qëllimi i diskutimit është arritja e konsensusit për veprim të koordinuar si hap i parë i formulimit të një strategjie të përbashkët në rang kombëtar.

Takimi do të zhvillohet me dt. **15 Maj 2008 ora 13.00** në QKCSA.

Për çdo pyetje apo sqarim eventual, si dhe për konfirmimin e pjesëmarrjes suaj ju jeni të mirëpritur të kontaktoni qendrën tonë në Tel:+355-42-23 42 21/Fax: +355-42-23 42 25, Email: info@qkcsaish.gov.al

Ju faleminderit për bashkëpunimin.

Me respekt

Prof. Isuf KALO

Dr. Edmond STOJKU

Drejtori i QKCSA

**Drejtor i Politikave dhe
Planifikimit Shëndetësor - MSH**